

BREAKING NEWS

x

KUVENDI MERR VENDIMIN ME TE FUNDIT, MIRATON KOMISIONIN E POSAÇEM HETIMO...

AKTUALITET

Durrës/ Grabitësit të veshur si policë lidhin dhe grabisin familjen e biznesmenit

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
13 JANAR 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një ngjarje e rëndë ka tronditur mbrëmjen e djeshme qytetin bregdetarë të Durrësit. Familja e një biznesmeni në zonën e Shkozetit është terrorizuar nga maskat dhe në mbrëmje, ku nënë kërcënimit e armës biznesmenit i janë marrë rreth 10 mijë euro. Kanë qenë tre persona të cilët kanë hyrë në banesën e biznesmenit dhe nën kërcënimit e armëve kanë lidhur atë së bashku me bashkëshorten dhe më pas kanë kontrolluar shtëpinë, ku pasi arritën ti gjejnë paratë i kanë marrë dhe janë larguar menjëherë nga banesa e biznesmenit. Mësohet se në momentin kur kanë

gjetur shumën e konsideruar të parave, tre grabitësit kur janë larguar kanë marrë

përjetojë ka shkuar në komisariatit e policisë së qytetit bregdetar të Durrësit, ku ka bërë kallëzimin. Ai ka thënë përpara uniformave blu që kanë qenë tre persona të veshur me uniforma policie që e kanë sulmuar duke i hyrë me dhunë në banesë dhe pasi e lidhën i morën sasinë e parave. Menjëherë pas denoncimit policia ngriti një grup hetimor për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje të rëndë. Menjëherë policia ka ngritur pika kontrolli në të gjithë zonën, por ende nuk dihen personat e kësaj ngjarje të rëndë. Edhe pse të terrorizuar, biznesmeni dhe familjarët e tij janë shoqëruar në polici për të dhënë dëshmi rreth kësaj ngjarje. Emri i biznesmenit nuk bëhet me dije ndërsa mësohet se aktiviteti i tij ishte kryesisht në transportin ndërkombëtar.

Ngjarja dhe Hetimet

Tre persona të paidentifikuar dhe me maska në kokë kanë grabitur një biznesmen në Shkozë të Durrësit. Grabitësit nën presionin e armëve mësohet se kanë lidhur familjarët brenda në shtëpi dhe prej aty kanë marrë sasinë e eurove dhe janë larguar. Në ikje e sipër, grabitësit kanë marrë edhe djalë të familjes, por e kanë lënë të lirë disa kilometra më tutje. I frikshëm është fakti se grabitësit kanë qenë të veshur me uniforma policie kur kanë sulmuar biznesmenin, i cili operon në transportin ndërkombëtarë. Biznesmeni së bashku me bashkëshorten dhe djalë të tij të mitur pasditen e djeshme kishte dalë për të konsumuar kafe. Sipas dëshmisë së tij në momentin që po kthehej në banesën që ndodhet në zonën e Shkozës, në hyrje të saj, biznesmenit i kanë bërë pritë tre persona të veshur me uniforma policie. Në kërcënimin e armës ata i kanë futur brenda banesës së tyre tre

familjarë ku kanë lidhur biznesmenin dhe bashkëshorten e tij. Njëri nga grabitësit

paratë, janë larguar menjëherë nga zona e ngjarjes dhe ngjarjes së biznesmenit. Njëri nga policitë ku denoncoi ngjarjen e rëndë. Menjëherë policia ngriti pika të shumta kontrolli në pikat hyrëse dhe dalëse të qytetit bregdetar. Gjithashtu policia sekuestroi kamerat e sigurisë së banesës së biznesmenit të sulmuar si dhe disa kamera sigurie në zonë, ku shpresohet identifikimin e autorëve të kësaj ngjarjeje të rëndë. Kujtojmë se rreth një muaj më parë, në zonën e Shkozetit, po tre persona të armatosur dhe të maskuar grabitën rreth 7.5 milionë lekë të reja nga një makinë e cila po transportonte paratë e Drejtorisë së Patentave. Pa u zbardhur ngjarja e një muaji më parë, mbrëmjen e sotme u krye një tjetër grabitje, ndërsa nga autorët nuk ka asnjë gjurmë. Burime nga Policia e qytetit bregdetar të Durrësit thonë se ka dyshime të forta se biznesmeni është sulmuar nga i njëjti grup që grabiti automjetin që po transportonte paratë e Drejtorisë së Patentave. Nga mënyra se si u sulmua biznesmeni nga autorët është pak a shumë e njëjta me atë të një muaj më parë.

YOU MAY LIKE

by mgid



Pronađen glavni neprijatelj
dijabetesa! Šećer brzo pada do
4,1

DIATEA